

### **RIKLASIFIKIMI I IDENTIFIKUAR I DYFISHTË (i dalë) NGA ESL**

I dashur Prind / Kujdestar,

Ne po shkruajmë për t'ju informuar se fëmija juaj po konsiderohet për riklasifikim (dalje) nga programi anglishtja si gjuhë e dytë (ESL). Veçanërisht, fëmija juaj mund të kualifikohet për riklasifikim të identifikuar të dyfishtë, për nxënësit që mësojnë Anglisht si gjuhë të dytë të cilët gjithashtu kanë një Plan të Edukimit Individual (IEP).

Për t'u kualifikuar për riklasifikim të identifikuar të dyfishtë, një ekip në bazë shkolle ose IEP, **përfshirë një prind / kujdestar**, duhet të rekomandojë fëmijën tuaj për këtë riklasifikim të identifikuar të dyfishtë. Vendimi juaj për riklasifikim do të varet nga (1) nëse fëmija juaj po bën përparim drejt përmbushjes së standarteve të nivelit të klasës, dhe (2) nëse fëmija juaj ka aftësi të mjaftueshme për gjuhën angleze për të pasur sukses në shkollë pa mbështetjen e ESL.

Për të filluar këtë proces, **ne do t'ju kontaktojmë për të caktuar një takim**. Në takim, ne do të diskutojmë për progresin akademik të fëmijës tuaj dhe aftësitë në gjuhën angleze dhe të përcaktojmë nëse reklasifikimi është i përshtatshëm për fëmijën tuaj. Ju lutemi vini re **se ju duhet merrni pjesë patjetër** në këtë takim që fëmija juaj të riklasifikohet. Interpretimi do të jepet në mbledhje nëse është e nevojshme.

Vendimet e riklasifikimit gjithashtu varen nga pikët e ACCESS exam të vitit 2020. Është shumë e rëndësishme që fëmija juaj të **marrë provimin ACCESS 2020**, i cili do të administrohet në shkollën e fëmijës tuaj diku midis 6 janarit dhe 21 shkurtit 2020.

Nëse fëmija juaj është riklasifikuar, ai/ajo nuk do të ketë më të drejtë të marrë mbështetje të drejtpërdrejtë nga një mësues i ESL duke filluar në vitin shkollor 2020-21. Në vend të kësaj, fëmija juaj do të marrë vetëm mbështetje të përgjithshme nga mësuesit së bashku me shërbimet e arsimit special të mandatuara në IEP të tij / saj. Për më tepër, performanca akademike e fëmijës tuaj do të vazhdojë të monitorohet.

Nëse keni pyetje të mëtejshme, ju lutem më kontaktoni duke përdorur informacionin e kontaktit të listuar më poshtë. Dikush nga shkolla jonë do të jetë në kontakt së shpejti në lidhje me hapat e ardhshëm. Ne mezi presim të takohemi me ju.

Sinqerisht,

Emri: \_\_\_\_\_

Roli: \_\_\_\_\_

Email: \_\_\_\_\_

Telefon: \_\_\_\_\_

**RIKLASIFIKIMI I IDENTIFIKUAR I DYFISHTE (i dalë) NGA ESL  
PYETJE MË TË SHPESHTA**

**1. Çfarë do të thotë të jesh një nxënës i gjuhës Angleze?**

Nxënësi i gjuhës angleze (EL) është identifikuar si i tillë sepse ka nevojë për shërbime në gjuhën angleze, të cilat ofrohen përmes Programit të Arsimit të Gjuhës (LIEP), i njohur zakonisht si Anglishtja si Gjuhë e Dytë (ESL). Qëllimet e ESL janë: (1) të ndihmojnë nxënësit të fitojnë aftësi në gjuhën angleze, dhe (2) të sigurojnë që të gjithë nxënësit të arrijnë nivelin e klasës .

**2. Cili është saktësisht qëllimi i programit të gjuhës angleze si gjuhë e dytë?**

Qëllimi i programit të gjuhës Angleze si gjuhë e dytë (ESL) është të ndihmojë fëmijën tuaj të mësojë gjuhën angleze në mënyrë që ai të jetë në gjendje të kuptojë mësimet e përditshme, të marrë pjesë në mënyrë shoqërore në shkollë dhe të plotësojë standartet akademike të përshtatshme për kalimin e klasës dhe diplomimin .

**3. Si u identifikua fëmija im si një nxënës i gjuhës angleze?**

Kur prindërit / kujdestarët regjistrojnë fëmijën e tyre në shkollat e Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, ata plotësojnë një pyetësor "Home Language Survey" që është bashkangjitur me dokumentat e tjera të regjistrimit. Bazuar në përgjigjet e pyetësorit, fëmija juaj do të bëjë një provim në anglisht, dhe në bazë të aftësive, të rezultateve, fëmija juaj do të përcaktohet nëse ai /ajo ka nevojë për shërbime në gjuhën angleze.

**4. Çfarë do të thotë të jesh një nxënës i identifikuar dy herë?**

Nxënësi "i identifikuar dy herë" merr shërbime të gjuhës Angleze dhe ka një Program Individual Arsimor (IEP) dhe i merr të dyja shërbimet; shërbime të Edukimit Special dhe Shërbime Gjuhësore (gjuhën Angleze).

**5. Çfarë është provimi ACCESS?**

ACCESS për ELs EL është një vlerësim që mat aftësinë e fëmijës tuaj në anglisht. Ky vlerësim jepet midis janarit dhe shkurtit të çdo viti shkollor dhe administrohet ose në internet ose me letër dhe laps. Nxënësit marrin një rezultat prej 1.0 - 6.0 (6.0 është më i larti). Një grup i vogël i nxënësve EL me IEP bëjnë provimin Alternativ ACCESS, i cili është një version alternativ i ACCESS.

**6. Çfarë testohet në provimin ACCESS?**

ACCESS mat aftësitë angleze të nxënësve në lexim, shkrim, të folur dhe dëgjim. Këto fusha zakonisht quhen "Domain". Cdo fushë ka një rezultat i cili, i marrë së bashku, prodhon një rezultat të përgjithshëm të përbërë, i njohur gjithashtu si niveli i aftësive angleze të fëmijës tuaj.

**7. Çfarë do të thotë të riklasifikohet (të dalë) nga ESL?**

Nxënësi riklasifikohet kur provat (rezultatet e testit ACCESS dhe informacionet nga mësuesit) tregojnë se nxënësi është proficient në anglishten akademike. Pasi nxënësit janë riklasifikuar, performanca e tyre akademike monitorohet në mënyrë aktive nga Distrikti i Filadelfia për dy (2) vjet, dhe monitorohet nga

Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë (PDE) për katër (4) vjet. Nëse përcaktohet gjatë dy viteve të para të monitorimit se nxënësi ka vështirësi akademike si rezultat i pengesave të vazhdueshme gjuhësore, atëherë nxënësi mund të futet përsëri si Nxënës aktiv në mësimin e anglishtes dhe të ri-regjistrohet në programin anglishtja si gjuhë e dytë (ESL).

### **8. Si e di nëse fëmija im është një kandidat i mirë për riklasifikim?**

Nëse fëmija juaj është proficient (i aftë) ose afërsisht proficient (i aftë) me njohuri të gjuhës angleze akademike dhe po përparon drejt përmbushjes së standarteve të nivelit të klasës, ai / ajo mund të jetë një kandidat i mirë për riklasifikim.

### **9. A është kjo mënyra e vetme që fëmija im mund të riklasifikohet (të dalë) nga ESL?**

Ekzistojnë dy rrugë për riklasifikim (dalje) nga anglishtja si një program i gjuhës së dytë (ESL). Riklasifikimi i parë, i përgjithshëm, kërkon që nxënësit të arrijnë një 4.5 ose më lart në provimin ACCESS dhe të rekomandohen për riklasifikim nga mësuesit e tyre. Riklasifikimi i dytë, i identifikuar në mënyrë të dyfishtë, është për një grup të përzgjedhur të nxënësve të anglishtes si gjuhë e dytë, të cilët gjithashtu kanë Plane të Edukimit Individual (IEP), dhe për të cilët provimi ACCESS mund të mos jetë një masë e përshtatshme e aftësisë angleze të nxënësit. Në të dy proceset, aftësia akademike angleze është një kërkesë për riklasifikim.

### **10. A do të vazhdojë fëmija im të marrë ndihmë të gjuhës angleze nëse ai / ajo është riklasifikuar?**

Nxënësit që janë riklasifikuar marrin ndihmë të përgjithshme nga mësuesit, por nuk marrin udhëzime (instruksione) të anglishtes si gjuhë e dytë ose ndonjë ndihmë tjetër shtesë, specifike për nxënësit që mësojnë anglisht si gjuhë të dytë.

### **11. A do të vazhdojë fëmija im të marrë ndihmë të Arsimit Special nëse ai / ajo është riklasifikuar?**

Po. Fëmija juaj do të vazhdojë të marrë ndihmë dhe udhëzime të veçanta arsimore siç përcaktohen në IEP e fëmijës tuaj.

### **12. Cili do të jetë roli im në takimin e riklasifikimit të identifikuar në mënyrë të dyfishtë?**

Në takimin e riklasifikimit të identifikuar të dyfishtë ju do të punoni me mësuesit e fëmijës tuaj për të rishikuar rezultatet e tij / saj të punës dhe testimit. Pas rishikimit të këtyre artikujve do të përcaktoni në mënyrë kolektive nëse fëmija juaj ka aftësi të mjaftueshme në anglisht për t'u riklasifikuar. Nëse besoni se fëmija juaj nuk duhet të riklasifikohet, shkolla duhet ta respektojë këtë vendim.

### **13. Çfarë do të ndodhë nëse nuk jam në gjendje të marr pjesë në mbledhjen e riklasifikimit?**

Një prind / kujdestar duhet patjetër të marrë pjesë në të gjitha takimet e riklasifikimit të identifikuar në mënyrë të dyfishtë. Nëse nuk jeni në gjendje të merrni pjesë, fëmija juaj nuk do të ketë të drejtë për procesin e riklasifikimit të identifikuar në mënyrë të dyfishtë këtë vit shkollor.

### **14. A jam në gjendje të marr pjesë në takimin e riklasifikimit përmes telefonit ose konferencës me video?**

Po, ju mund të merrni pjesë në takim përmes telefonit ose konferencës me video.

**15. A do të jenë të disponueshme shërbimet e interpretimit gjatë takimit të grupit bazë të shkollës?**

Po, mund të jetë në dispozicion një Asistent Këshillëdhënës dygjuhësh (BCA) për t'ju ndihmuar me interpretim, por në mungesë, shkolla do të jetë në gjendje të hyjë në linjën telefonike të interpretimit të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Ju lutemi të kërkonti këto shërbime kur shkolla t'ju kontaktojë.

**16. Ku mund të mësoj më shumë rreth procesit të riklasifikimit?**

Ju mund t'i shihni kriteret për riklasifikim në uebsajtin (uebfaqen) e Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë në <https://www.education.pa.gov/>. Pasi të keni hyrë në faqen e internetit, kërkonti dokumentin me titull "Riklasifikimi, monitorimi dhe ridizenjimi i NV".